



Prishtinë, 04.10.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1405\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2210\_07\_21** i dt.23.07.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **17.08.2021**;

### në seancën e mbajtur më datë 04.10.2021 nxori këtë:

#### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, ndaj konsumatorit I.K – DGL 9022295 nga Komuna e Kamenicës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2210\_07\_21, i datës 23.07.2021.

#### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 23.07.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2210\_07\_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit I.K dhe e ka obliguar KESCO-n që ta shkarkoj shifrën DGL – 9022295 nga korrigjimi urdhër lejimi / ngarkimi i dt. 13.01.2015 në vlerë prej 882.18 EUR, dhe po ashtu e ka obliguar KESCO-n që për borxhin e krijuar në shifrën DGL – 82024 ta kërkoj përmes procedurave gjyqësore.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori I.K me datë 09.01.2018 ka nënshkruar deklaratën me nr. 61286 mbi dakordimin e borxhit, sipas të cilën borxhi në vlerë prej 1,035.36 EUR falet sipas Ligjit nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike dhe këtu përfshihet edhe borxhi i bartur prej 882.18 EUR.
- Në kartelën e konsumatorit DGL – 9022295, me referencën nr. KEK\_15\_09.01.2018 pasqyrohet vlera financiare -1,035.36 EUR në të cilën falet borxhi paraprak në të cilin është i përfshirë edhe borxhi i bartur në vlerë prej 882.18 nga shifra DGL – 82024.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2210\_07\_21 i datës 23.07.2021 për konsumatorin I.K.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi në veçanti ka administruar provat si në vijim: Urdhër Lejimin/Ngarkimin e dt. 13.01.2011, Ankesën e konsumatorit në KEK, Përgjigjen e KEK-ut të dt. 02.03.2016, Ankesën e konsumatorit në DMK, Vendimin e DMK, Kundërshtimin e KESCO-s, Transaksionet e konsumatorit dhe Rrjedhën e Energjisë Elektrike, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha këtyre provave vec e vec, ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Shifra DGL – 9022295 është regjistruar nga data 21.11.2007 përmes taksës për shërbime për lidhje të reja, dhe se nga periudha 12/2007 ka filluar të faturohet me fatura të energjisë elektrike, si dhe kjo shifër është regjistruar në emër të I.V.K.
- Me datë 13.11.2011 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me një ngarkesë prej 882.13 EUR dhe atë përmes Urdhër Lejimit/ngarkimit, pra është bërë transferimi (bartja) e borxhit nga shifra DGL 82024 në DGL 9022295.
- Shifra DGL – 82024 ka filluar të faturohet nga periudha 08/2002 dhe se nga kjo periudhë e tutje është faturuar sipas shpenzimeve reale të regjistruara në njehsorin elektrik deri me 11/2007, ndërsa nga periudha 11/2007 është faturuar pa shpenzim por vetëm me taksa.
- Sipas Përgjigjes se KESCO-s të dt. 02.03.2016 ankesa e konsumatorit është refuzuar me arsyetimin se, sipas procesverbalit të specialistit të daljes, është theksuar se, konsumatori ka pasur shtëpi në Karaçevë të Poshtme, në emër të prindit V. K, ku të njëjtën shtëpi e ka lënë të pabanueshme dhe e ka rrënuar dhe ka rindërtuar shtëpi të re.
- Mbi këtë bazë, shkalla e parë në ZRrE, me të drejtë ka konstatuar se shifra DGL – 82024 ka qenë e regjistruar në emër të V.K dhe se KEK-u në atë kohë i ka pasur të gjitha dispozitat ligjore që borxhin e krijuar në atë shifër ta inkasojë, ose të iniciojë procedurë gjyqësore për ta inkasuar.

Ndërkaq, lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që borxhi në vlerën prej 882.18 EUR është ekzekutuar përmes faljes së borxhit, ZRrE thekson se, siç edhe është konstatuar në vendimin kontestues, ZRrE nuk është kompetente për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me faljen e borxheve, dhe se lënda është trajtuar në kuptim të transferimit të borxhit nga një shifër në shifrën tjetrën.

Bordi i ZRrE po ashtu sqaron se, nëse borxhi në fjalë është ekzekutuar sipas Deklaratës dhe Kontratës nr. 61286 të dt. 09.01.2018, atëherë borxhi prej 882.18 EUR nuk do të duhej të korrigohej për të dytën herë. Për më shumë, DMK si shkallë e parë në ZRrE ka sqaruar se bartja e borxhit nga një shifër në shifrën tjetër, është kundër rregullave në fuqi, andaj edhe konsumatori me shifër DGL – 9022295 është dashur të shkarkohet nga urdhër lejimi/ngarkimi i dt. 13.01.2011 në vlerë prej 882.18 EUR. Nëse në ndërkohë, sipas deklaratës dhe kontratës së lartpërmendur, ky borxh është përfshirë në falje të borxhit, ZRrE në asnjë mënyrë nuk do ta obligojë KESCO-n që të bëjë korrigjim të dyfishtë.

ZRrE sqaron se në nenin 5, paragrafi 3, nënparagrafi 3.9, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“sigurojë lexim të saktë dhe të Rregullt të njehsorëve”*, në nenit 26 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“Operatori i Sistemit mund t’ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, Operatori i*



*Sistemit mbetet përgjegjës për të siguruar lexim të saktë dhe të rregullt dhe do të sigurojë që entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve, do të bëjë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin përkatës të Matjes. Operatori i Sistemit duhet të krijoj dhe paraqes procedurën për lexim të njehsorëve të konsumatorëve në Rregullator për shqyrtim dhe miratim”; si dhe në nenin 28, paragrafi 1, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: “Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”. Pra, duke u bazuar në dispozitën e sipërshtuar, Bordi konstaton se bartja e borxhit nga një shifër (tjetër konsumatorë) tek një shifër tjetër (konsumatori tjetër), i cili nuk ka shkaktuar shpenzimin e supozuar të energjisë elektrike është kundër rregullave në fuqi.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit I.K. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar